



Legal Alert Albania

Draft Law “On Classified Information”

Projektligji “Për informacionin e klasifikuar”

Hartimi i Projektligjit nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar “Për informacionin e klasifikuar” ka për qëllim mbrojtjen e kësaj kategorie informacioni nga humbja, dëmtimi, rrjedhja, komprometimi dhe/ose ekspozimi i pa autorizuar.

Inicimi i këtij projektligji lidhet me nevojën për të përditësuar kuadrin ligjor për informacionin e klasifikuar, si dhe për të harmonizuar e përshtatur sa më mirë kuadrin ligjor për disiplinat e informacionit të klasifikuar me standardet e vendeve të Bashkimit Evropian dhe të NATO-s.

Risitë e këtij projektligji janë:

- Rregullimi i disiplinave për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar si: “Siguria e sistemeve të komunikimit dhe informacionit” dhe “Siguria industriale”, të cilat nuk kanë qenë të rregulluara në ligjin aktual
- Përcaktimi në ligj i autoriteteve përgjegjëse për menaxhimin dhe garantimi i aspekteve të sigurisë si më poshtë:
 - a) Autoriteti Kombëtar i Akreditimit të Sigurisë
 - b) Autoriteti Kombëtar i Testimit dhe Vlerësimit të Sigurisë
 - c) Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar
 - d) Autoriteti Kombëtar i Sigurisë së Komunikimeve
 - e) Autoriteti Kombëtar i Shpërndarjes
 - f) Autoriteti Kombëtar TEMPEST
 - g) Autoriteti Kombëtar i Mbrojtjes Kibernetike

Draft law “On classified information”

This draft law proposed by the Directorate of Classified Information Security "On classified information" aims to protect this category of information from loss, damage, leakage, compromise and/or unauthorized exposure.

The initiation of this draft law is related to the need to update the legal framework for classified information, as well as to harmonize and adapt as best as possible the legal framework for the disciplines of classified information with the standards of the European Union and NATO countries.

The innovations of this draft law include the following:

- Regulation of disciplines for the protection of information classified as: "Security of communication and information systems" and "Industrial security", which have not been regulated in the current law
- The definition in law of the authorities responsible for the protection of classified information in the communication and information systems, which are:
 - a) National Authority of Security Accreditation
 - b) National Authority of Testing and Security Assessment
 - c) National Authority for Classified Information Security
 - d) National Authority of Communications Security
 - e) National Authority of Distribution
 - f) National Authority of TEMPEST
 - g) National Authority of Cyber Protection

Projektligj "Për informacionin e klasifikuar"

- Trajtimi i parimit "after care", i cili parashikon se masat e sigurisë dhe verifikimi i sigurisë për personat që kanë qasje tek informacioni i klasifikuar vazhdon edhe pas çertifikimit të përshtatshëm të tyre dhe autorizimit për njohje me informacionin e klasifikuar
- Detajimi i kategorive të informacionit që do t'i nënshtrohen procesit të klasifikimit duke e bërë më të lehtë orientimin e institucioneve për të hartuar listat e informacioneve të klasifikuara
- Përfshirja e procedurave të verifikimit të sigurisë për Presidentin e Republikës së Shqipërisë dhe Kryeministrin, të cilët autorizohen të kenë qasje tek informacioni i klasifikuar, për shkak të kryerjes së detyrave të tyre zyrtare
- Në projektligj është trajtuar edhe informacioni i klasifikuar i Bashkimit Evropian, i cili regjistrohet, shpërndahet, administrohet, sipas standardeve që sigurojnë shkallë mbrojtjeje të njëjta me atë që kërkohet nga Bashkimi Evropian, në zbatim të marrëveshjeve të përgjithshme të sigurisë
- Në projektligj është parashikuar deklasifikimi i pjesëshëm, duke rregulluar për herë të parë mundësinë për të zbuluar në mënyrë të autorizuar informacione, të cilat mund të ndahen nga informacioni që nuk mund të deklasifikohet
- Rritja e kuadrit të transparencës lidhur me publikimin e çështjeve të ndërlidhura me detyrimet e palëve në kontratë, pa e cënuar sigurinë e informacionit të klasifikuar
- Për herë të parë është përkufizuar koncepti i pronësisë së huaj, si formë kontrolli apo influencë kërcënuese për sigurinë e informacionit të klasifikuar për llogari dhe në interes të vendeve apo palëve jomike
- Për herë të parë janë përcaktuar shkeljet e sigurisë, duke i ndarë ato në të rënda e të lehta
- Gjithashtu, janë vendosur masa administrative ndaj subjekteve të cilat kryejnë këto shkelje

Draft law "On classified information"

- The treatment of the "after care" principle, which provides that security measures and security verification for persons who have access to classified information continues even after their appropriate certification and authorization for familiarization with classified information
- Detailing the categories of information that will be subject to the classification process, making it easier to guide institutions to draw up lists of classified information
- Exclusion of security verification procedures for the President of the Republic of Albania and the Prime Minister, who are authorized to have access to classified information, due to the performance of their official duties
- The draft law also deals with classified information of the European Union, which is recorded, distributed, administered, according to standards that ensure the same degree of protection as that required by the European Union, in implementation of general security agreements
- The draft law provides for partial declassification, regulating for the first time the possibility to disclose information in an authorized manner, which can be separated from information that cannot be declassified
- Increasing the transparency framework related to the publication of issues related to the obligations of the parties to the contract, without compromising the security of classified information
- For the first time, the concept of foreign ownership has been defined as a form of control or threatening influence on the security of classified information for the account and in the interest of foreign countries or parties
- For the first time, security violations have been defined, dividing them into serious and minor
- Also, administrative measures have been imposed on subjects who commit these violations

How can PwC Albania assist you?

Si mundet t'ju vijë në ndihmë PwC Shqipëri?

PwC mund të ndihmojë të gjitha palët e interesuara në identifikimin e personave që janë subjekt të këtyre vendimeve, përgatitjen e dokumentacionit të nevojshëm, dhe ndjekjen e procedurave ligjore për të përfituar nga dispozitat. PwC me eksperiencën dhe ekspertizën kros-sektoriale mbetet partneri juaj i besuar për të gjithë gamën e shërbimeve taksë -audit- shërbime ligjore.

How can PwC Albania assist you?

PwC can assist all stakeholders in identifying persons who are subject to these decisions, preparing the necessary documentation, following legal procedures to benefit from these provisions. PwC with its cross-sectoral experience and expertise remains your trusted partner for the full range of tax -audit- legal services. PwC with its cross-sector experience and expertise remains your trusted partner for the entire range of tax - audit - legal services.

Let's talk

PricewaterhouseCoopers Albania

Str. "Ibrahim Rugova", Sky Tower,
9/1 Tirana, Albania

Telephone: +355 4 22 90 700

Email: al_pwc_albania@pwc.com

Web: www.pwc.com/al

